

Hapet Thirrja për bursa për stafin akademik për mësimdhënie të Universitetit të Tiranës në Programin Erasmus + në Universitetin e Paviors, në Itali.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Paviors, në Itali për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (160 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

Between 10 and 99 KM	20 EUR per participant
Between 100 and 499 KM	180 EUR per participant
Between 500 and 1999 KM	275 EUR per participant
Between 2000 and 2999 KM	360 EUR per participant
Between 3000 and 3999 KM	530 EUR per participant
Between 4000 and 7999 KM	820 EUR per participant
8000 KM or more	1500 EUR per participant

Procedura e aplikimit kryhet online.

- Kandidati i interesuar për zgjedh një pedagog nga departamenti respektiv në Universitetin e Paviors për të shprehur interesin për të kryer një periudhë shkëmbimi duke dërguar përmes e-mail CV e tij/saj për të treguar fushën e ekspertizës dhe si të dy universitetet mund të përfitojnë nga ky aktivitet. Ju mund të gjeni të dhënat e kontaktit në adresën e website <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>
- Kandidati duhet të plotësojë dokumentin “Mobility agreement/Teaching programme” duke u konsultuar me pedagogun e përzgjedhur mbi aktivitetet që do të zhvillojë gjatë periudhës të shkëmbimit.
- Kandidati duhet të plotësojë aplikimin online në adresën <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Dokumenti “Mobility agreement (teaching programme) i firmosur nga aplikanti dhe departamenti i Universitetit të Pavia dhe Universiteti i Tiranës;”
- Kopje të pasaportës;
- Vërtetim punësimi të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane;

*** Mobility agreement/teaching programme për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj dhe nga Universiteti i Parias.*

Për të shkarkuar formatin e Mobility agreement/teaching programme ju lutemi vizitoni <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>

Për të aplikuar ju lutemi vizitoni: <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html>

Afati për aplikim: 28 Nëntor ora 12 p.m (ora italiane).

Për më shumë informacion mbi bursat vizitoni <http://www.unipv.eu/site/en/home/international-relations/erasmus--overseas/teaching-staff.html> ose mund të na kontaktoni në adresën iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin Tuaj.